

VENDIM
Nr. 342, datë 21.12.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 83, DATË 31.5.2019, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SANG 1’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘THIRRË’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1820 kw, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurale ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2094/1 prot., datë 19.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.5.2019, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Sang 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Thirrë’, me kapacitet të instaluar 1820 kw’, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 83, datë 31.5.2019, të ndryshuar, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Sang 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë”, me kapacitet të instaluar 1820 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “Sang 1” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor nr. 97, prot., datë 8.5.2017, përpara datës 27.4.2022.

- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje dhe më tej ka vijuar korrespondencat drejtuar shoqërisë, në lidhje me plotësimin e këtij kushti.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 845/1, datë 31.5.2022, shoqëria “Sang 1” sh.p.k. ka bërë me dije se ka aplikuar dhe është në pritje të rinovimit të lejes të përdorimit të burimit ujor nga Agjencia e Mbrotjes së Burimeve Ujore (AMBU).

- ERE, në vijim të takimit të datës 2.6.2022, me përfaqësues të AMBU-së, ka shkëmbyer korrespondenca të vazhdueshme me këtë institucion, ku së fundi edhe me shkresën nr. 1833 prot., datë 18.10.2022, në lidhje me konstatimin nga AMBU-ja të disa HEC-eve që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, pa pasur leje të përdorimit të burimit ujor, duke i kërkuar ndër të tjera informacion në lidhje me mënyrën se si do të konsiderohen subjektet që kanë aplikuar për rinovimin e lejes për përdorimin e burimit ujor përkatës dhe gjatë këtij procesi i përfundon afati i vlefshmërisë së lejes me të cilën është pajisur, siç rasti i shoqërisë “Sang 1” sh.p.k., së cilës i ka përfunduar leja në datën 27.4.2022 dhe ka bërë me dije ERE-n se ka aplikuar fillimisht në datën 16.3.2022 dhe më pas ka riaplikuar përsëri në datën 26.4.2022.

- Në përgjigje të sa më sipër me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1833/1, datë 21.10.2022, AMBU, ndër të tjera ka kthyer përgjigje edhe për shoqërinë “Sang 1” sh.p.k., duke cilësuar se kjo shoqëri ka aplikuar për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujor për HEC “Thirrë” dhe aplikimi është në fazën e kryerjes së pagesës së tarifës për marrjen e lejes nga subjekti përfitues.

- Në vijim me shkresën nr. 2055/1 prot. datë 14.12.2022, shoqëria “Sang 1” sh.p.k. ka depozituar vendimin nr. 23, datë 12.10.2022, “Për miratimin e saktësisimit të koordinatave dhe rinovimin e lejes, HEC “Thirrë” dhe lejen për përdorim burimi ujor sipërfaqësor nr. 433 , datë 24.10.2022, me afat vlefshmërie 5 vjet.

- Me depozitim të dokumentacionit si më sipër nga shoqëria “Sang 1” sh.p.k. vlerësojmë që pika 2 e vendimit të Bordit nr. 83/2019, të ndryshuar, të ndryshojë dhe bëhet:

“2. Shoqëria “Sang 1” sh.p.k. të përcjellë në ERE jo më vonë se data 13.10.2027, lejen e përdorimit të burimit ujor me afat të rinovuar (data e përfundimit të lejes 12.10.2027).”.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e dispozitivit të vendimit nr. 83/2019, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “Sang 1” sh.p.k. të përcjellë në ERE jo më vonë se data 13.10.2027, lejen e përdorimit të burimit ujor me afat të rinovuar (data e përfundimit të lejes 12.10.2027).”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti